



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Në mbështetje të nenit 150 dhe 152 të Statutit të OAK-së, Rregullores për stafin e OAK-së, neni 7, 9, 29 dhe 33 dhe Udhëzimit Administrativ 07/2017, për Rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Këshilli Drejtues i OAK-së, shpallë:

## KONKURS

për vend të lirë të punës

**Pozita: Drejtor Ekzekutiv**

**Koeficienti: 12,5**

### I. Kushtet:

Kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Fakultetin Juridik (katërvjeçar ose Bachelor + Master);
2. 5 vite përvojë pune në pozita menaxheriale;
3. Të ketë të dhënë provimin e Jurisprudencës;
4. Njohja e punës me kompjuter (Programet e windows-it) e obligueshme;
5. Njohja e gjuhëve zyrtare (njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme).

Tek kandidatët do të vlerësohet: afiniteteti, kreativiteti, shkathhtësitë profesionale, aftësia për të përballuar punën nën presion.

### II. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË:

1. organizon, udhëheqë dhe mbikëqyrë stafin e OAK;
2. organizon punët ditore të stafit të OAK-së;
3. koordinon aktivitetin e Kryetarit dhe të Këshillit Drejtues të OAK-së;
4. mbikëqyrë të gjitha punët administrative dhe financiare të OAK-së;
5. përcjellë dhe koordinon punën e të gjitha komiteteve dhe grupeve të OAK-së, personalisht apo përmes stafit të OAK-së;
6. mbanë evidencë, merr dhe përpilon vendime, raporte njoftime e shkresa tjera që lidhen me aktivitetet e OAK-së;
7. përgatitë sqarime, komente, opinione ligjore për statutin, ligjin dhe aktet normative për nevojat e Kryetarit, të Këshillit Drejtues dhe organeve tjera;
8. organizon zbatimin e vendimeve të Këshillit dhe Kryetarit;
9. organizon përgatitjen e akteve normative;
10. përfaqëson OAK-në, në lëndët gjyqësore - administrative;
11. mbanë evidencën e punëtorëve sipas ligjit;
12. përpilon vendime, kontrata, shkresa etj;
13. zbaton urdhrat dhe udhëzimet e Këshillit Drejtues dhe të Kryetarit,
14. mbikëqyrë shpenzimet buxhetore;
15. kryen punë të tjera sipas udhëzimeve të Këshillit Drejtues dhe Kryetarit.

**KOHËZGJATJA E PUNËSIMIT:**

Punësimi është me afat të pacaktuar, pas përfundimit me sukses të periudhës provuese prej 6 (gjashtë) muaj.

**DATA E MBYLLJES SË KONKURSIONIT:**

Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë prej ditës së shpalljes në gazetën lokale, në tabelën e shpalljeve të OAK-së dhe në web faqen e Odës së Avokatëve të Kosovës: [www.oak-ks.org](http://www.oak-ks.org).

**PARAQITJA E APLIKACIONIT:**

Aplikacionet merren në web faqe të OAK-së dhe dorëzohen në zyrat e Odës së Avokatëve të Kosovës, Rr. "Bekim Fehmiu p.n." Kati IV, (Ndërtesa e Artingut) Prishtinë.

Aplikacionit i bashkangjiten: CV; një letër motivuese, dy referenca, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Kandidatët të cilën hynë në listën e ngushtë, për testim dhe intervistë do të informohen me shkrim ose nëpërmjet telefonit.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Odën e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, Rr. "Bekim Fehmiu p.n." Kati IV, (Ndërtesa e Artingut).

Për informata më të hollësishme të interesuarit mund të na drejtohen me anë të E-mail adresën: [info@oak-ks.org](mailto:info@oak-ks.org) ose në numrat e telefonit: +383 38/610 -101, çdo ditë pune prej orës 08:00 – 16:00.

Kërkesat e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.